



**REPUBLIKA E KOSOVËS**

*REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO*



**GJYKATA KOMERCIALE**

*KOMERCIJALNI SUD – COMMERCIAL COURT*

KPPP.nr. 135/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, lagjja Kalabria, rr. “Rexhep Krasniqi”, kundër debitorit N.T.SH. “A...”, me NRF:....., rr. “...”, nr. 22, Fushë Kosovë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 09/18 të datës 08.03.2018 të Përmbartuesit Privat Isak Shala, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 25.08.2022, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit N.T.SH. “A...”, me NRF:....., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 09/18 të datës 08.03.2018, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Isak Shala.

II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr. 09/18 të datës 08.03.2018, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Isak Shala sipas propozimit të kreditorit Dogana e Kosovës.

**A r s y e t i m**

Kreditori, Dogana e Kosovës ka parashtruar propozim për përmbartim kundër debitorit N.T.SH. “A...”, për përmbushjen e detyrimit sipas dokumentit përmbartues – Aktvendimi i Doganës së Kosovës – Sektori për kundërvajtje nr.03.1.7-2017/948/2, i datës 12.10.2017, i formës së prerë me datë 18.11.2017 dhe i ekzekutueshëm me datë 18.12.2017, me të cilin debitori është obliguar që kreditorit në emër të gjobës për kundërvajtje doganore t’ia paguaj shumën prej 500.00€

(pesëqind euro), pas pranimit të Aktvendimit, në xhirollogarinë e Doganës së Kosovës – Sektorit të Kontrollës Pas Importuese.

Përmbaruesi Privat Isak Shala, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Dogana e Kosovës, me datë 08.03.2018, ka lëshuar Urdhrin Përmbarimor P.nr.09/18, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit përmbarues, Aktvendimi i Doganës së Kosovës – Sektori për kundërvajtje nr.03.1.7-2017/948/2, i datës 12.10.2017. Kreditori në propozimin për përmbarim të datës 08.03.2018, ka kërkuar që të detyrohet debitori N.T.SH. “A...”, që në afat prej 10 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit, t’ia paguaj kreditorit Dogana e Kosovës, gjobën në shumën prej 500.00€ (pesëqind euro) nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm, nëse debitori nuk e përmbush detyrimin i njëjti të ngarkohet me kamatë vonesë si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore dhe shpenzimet tjera të krijuara, sipas Udhëzimit Administrativ MD.NR.06/2014.

Debitori N.T.SH. “A...”, brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim me shkrim, në të cilin ka theksuar se vendimi i Doganës së Kosovës është nxjerrë nën vërtetim të gabuar të gjendjes faktike pasi që automjeti i doganuar nuk shërben për transportin e mallrava ashtu siç e ka cilësuar Dogana e Kosovës por shërben vetëm për transporte të veçanta – tërheqje dhe barjte të makinave. Tutje ka shtuar se i njëjti përmes postës ka dorëzuar ankesë në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative me të cilën ka kërkuar të lirohet nga përgjegjësia dhe ka kërkuar që mos të bëhet përmbarimi i vendimit të kreditorit. Gjykatës i ka propozuar që ta ndryshoj propozimin për përmbarim dhe lëndën ta refuzoj si të pa bazë ose të prishet propozimi dhe lënda të kthehet në shqyrtim, ose i njëjti të hedhet si i palejuar.

Kreditori me përgjigje në prapësim i ka kundërshtuar pretendimet e debitorit në prapësim si të pabazuara për faktin se vendimet e nxjerra nga Dogana e Kosovës në procedurë administrative janë përfundimtare dhe ndaj tyre mund të ushtrohet pasi për iniciimin e konfliktit administrativ, e cila nuk ka efekt suspenziv dhe nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të kreditorit në procedurë përmbarimore. Gjykatës i ka propozuar që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar dhe urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigja në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji

Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata konstaton se organi përmbartues ka lejuar përmbartimin mbështetur në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka vlerësuar dokumentin përmbartimor Aktvendimi i Doganës së Kosovës – Sektori për kundërvajtje nr.03.1.7-2017/948/2, i datës 12.10.2017, në bazë të të cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafit paragrafit 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbartues sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Po ashtu Aktvendimi i Doganës së Kosovës – Sektori për kundërvajtje nr.03.1.7-2017/948/2, i datës 12.10.2017, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbartimor është i përshatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”,* pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktvendimi i Doganës së Kosovës – Sektori për kundërvajtje nr.03.1.7-2017/948/2, i datës 12.10.2017, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbartim, organit përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmëris për përmbartueshmëri”,* dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbartueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”,* ngase Aktvendimi i Doganës së Kosovës – Sektori për kundërvajtje nr.03.1.7-2017/948/2, i datës 12.10.2017, është bërë i formës së prerë me datë 18.11.2017 dhe i ekzekutueshëm me datë 18.12.2017.

Pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim janë pretendime të cilat janë paraqitur në procedurë administrative dhe të njëjtat janë vlerësuar nga organi administrativ në procedurë

administrative ashtu që të njëjtat pretendime nuk përbëjnë asnjërën nga shkaqet e përcaktuara në nenin 71, par.1 pika 1 deri 12 të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP) në të cilat mund të bazohet prapësimi dhe gjykata mund të vlerësoj ligjshmërinë e urdhërit përmbartimor.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit se i njëjti ka parashtruar padi për hapjen e konfliktit administrativ mirëpo gjeti se të njëjtat nuk gjejnë mbështetje ligjore ngase në nenin 22 të Ligji Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, është përcaktuar se: *“Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe”*. Andaj fakti se debitori ka parashtruar padi nuk paraqet pengesë për ekzekutimin e aktit administrativ në procedurën përmbartimore.

Më tej gjykata vlerëson se pretendimet e debitorit lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së dokumentit përmbartues nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përmbartimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbartimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, 24 dhe 27 të LPP-së

Nga arsyet e paraqitura më lartë, në bazë të nenit 21, 22 par.1 pika 1.2, 27, 36 par.1 dhe 2 dhe 73 par.3 të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.135/22, datë 25.08.2022

Gjyqtarja  
Verona Dibra

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomës së Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.